

AKTI I THEMELIMIT
TË
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
Bujtina "KASO" SH.P.K

Në Pogradec, sot më 29 Maj 2024 në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve" QKB-në unë Ortaku: **Kasëm Ramadan Galla** *me Kombësi dhe Shtetësi Shqiptare i identifikuar me "Letërnjoftim/card Shqiptare Nr 036081168, Nr ID personal G90925155I, me datë lindje 25.09.1969, i lindur dhe bamues në Pogradec* me Aktin e Themelimit të datës 29.05.2024 vendosa të krijoj Shoqërinë me Pergjegjësi të Kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K.** Për këtë qëllim hartojmë këtë "Akt Themelimi" me këto kushte:

Neni 1

Në kuptimin e këtij Akti Themelimi, ortaku **Kasëm Ramadan Galla**, është themelues i Shoqërisë me Pergjegjësi të Kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K.** me seli në adresën: **"Ndertesa me Nr.pasurie 9/157, Zona Kadastriale 3664, Sheshi Ollga, Fshati Tushemisht, Pogradec".** Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar emërtohet me emrin Bujtina "KASO" SH.P.K. bazuar në Legjislacionin Shqiptar në fuqi, rregullon pozitën juridike të ortakëve dhe pozitën juridike e statusin e administratorit të shoqërisë. Me këtë Akt Themelimi rregullohen të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të shoqërisë, të dhenat me rëndesi për pozitën dhe qëllimin juridik të saj, organizimi, aktiviteti finansiar, objekti i veprimtarisë të shoqërisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e saj.

Neni 2

Veprimtaria e Shoqërisë, marrëdhëniet e saj me persona të tretë, privatë e shtetërorë, rregullohen ne baze te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", te ligjit 9723 date 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar, QKB-në,) me akte të tjera ligjore e nënligjore të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme si dhe në bazë të Statutit e të këtij Akti Themelimi të Shoqërisë **Bujtina "KASO" SH.P.K.**

Neni 3

Për detyrimet e veta shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K.** përgjigjet me pasuritë e saja.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë, emërtimi, selia e shoqërisë, shtimi i ortakëve dhe ato çka janë përcaktuar në Statutin e Shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar Bujtina "KASO" SH.P.K mund të ndryshojnë me vendimin e Asamblesë së ortakëve dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.



Neni 5

Objekti i veprimtarisë së Shoqerisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K** do të jetë:

Bar-Restorant;Hotel;-Pastiçeri;-Piceri Muze Etnografi Suvenir shop, Shërbime të ndryshme ndaj publikut me transport brënda e jashtë vendit për udhëtarë dhe për mallra; Kërkim,Grumbullim, Përpunim, riciklim dhe tregtim i mbetjeve të ngurta metalore dhe jo metalore; -Import eksport dhe tregtim me shumicë dhe me pakicë i metaleve të ndryshëm në të gjitha format dhe i materialeve të tjera të ndërtimit; - Import eksport dhe tregtim me shumicë dhe me pakicë i të gjithë artikujve ushqimorë, i artikujve industrialë, i artikujve të duhanit dhe nën produkteve të tij, i artikujve të kafesë, dhe i artikujve bujqësorë; -Prodhim, import-eksport i lëndeve të para, i mallrave industriale dhe i mallrave të natyrave të tjera, i makinerive dhe i materialeve e paisjeve ndihmese për montimin dhe mirembajtjen e tyre; -Ngritje dhe përdorim i agjensive turistike, exchange-ve dhe i agjensive publicitare; -Ndërtim, riparim dhe mirëmbajtje i objekteve te banimit, i rrugëve, i objekteve sociale, i objekteve industriale, i objekteve bujqësore dhe i veprave të artit me karakter bujqësor, i kanalizimeve, i ujesjellsave dhe i shkarkueseve; -Investime dhe sipërmarrje për instalimin e sistemeve të ngrohjes dhe të freskimit të objekteve si gjatë procesit të ndërtimit ashtu dhe në në procesin e rikonstrukzionit të tyre; -Veprimtari në fushën imobilare si shitje, blerje dhe dhënie me qera të pronave dhe pasurive të paluajtshme; -Aktivitete prodhimi, shërbimi dhe punimi në kulturat bujqësore, në kultivimin e luleve natyrale, në pyje dhe në fushën e përpunimit dhe të tregtimit të artikujve bujqësorë e blegtoralë; -Tregti me shumicë e me pakicë i karburanteve të llojeve të ndryshme, i vajrave lubrifikantë dhe i nën produkteve të tjera të naftës. Të gjitha veprimtaritë e mësipërme do të realizohen në të drejtën e importit dhe eksportit komform kërkesave specifike të legjislacionit Shqiptar për secilën veprimtari.

Neni 6

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar Bujtina "KASO" SH.P.K. e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë. Ajo mund të krijojë filiale, degë e përfaqësi brënda e jashtë vendit në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe të vendeve të tjera ku mund të vendosë filiale ku do të ushtrojë aktivitetin.

Neni 7

Akti i Themelimit të Shoqerisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar Bujtina "KASO" SH.P.K do të jetë efektiv nga dita e regjistrimit të Shoqerisë në Regjistrin Tregtar pranë "Qëndrës Kombëtare të Biznesit", QKB. Nga kjo ditë, shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar Bujtina "KASO" SH.P.K fiton statusin e Personit Juridik të pavarur, por aktivitetin e saj mund ta ushtrojë pasi të jetë regjistruar në zyrat e Tatim-taksave dhe të jetë licensuar nga organet kompetente për ushtimin e veprimtarive ku liçensimi i aktivitetit është kërkesë detyruese nga ligjet specifike që rregullojnë aktivitetet.

Neni 8

Kohëzgjatja e aktivitetit të veprimtarisë së Shoqerisë tregtare me Përgjegjësi të kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K** do të jetë e pa kufizuar.

Neni 9

Kapitali Themeltar i Shoqërisë tregtare **Bujtina "KASO" SH.P.K** është 100.000 lek (njëqindmijë) lek. (Sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lek). Pjesmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë tregtare **Bujtina "KASO" SH.P.K** është në përputhje me kontributin e tij si më poshtë:

1. Kasëm Ramadan Galla është zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme në masën 100.000 lek e cila përbën 100% (njëqindpërqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.



Ky kapital në masën 100% do të jetë i derdhur tërësisht në bankë brënda 30 ditëve pas firmosjes së Statutit të Shoqërisë Tregtare Bujtina "KASO" SH.P.K. Kuotat e pjesëmarrjes në kapital janë të ndashme në rast suksedimi për shkak vdekjeje ose tjetërsimi. Në rast bashkëpronësia të një pjesemarrjeje, të drejtat e bashkëpronarëve duhet të ushtrohen nga një përfaqesues, i mandatuar, nga të gjithë të përfaqësuarit.

Neni 10

Administrator i Shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K.** do të jetë Z. Kasëm Ramadan Galla me Kombësi dhe Shtetësi Shqiptare e identifikuar me "Letërnjoftim/card Shqiptare Nr 036081168, Nr ID personal G90925155I, me datëlindje 25.09.1969, i lindur dhe banues në Pogradec, për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë riemërimi ose rizgjedhjeje nga "Asambleja e ortakëve" i cili nuk ndalohet nga ligji, nuk ka konflikte interesit dhe nuk është i lidhur në marrëdhënie te tjera në konceptin e personave të lidhur të cilat mund të prekin figurën e tij nga kërkesat e nenit 13 të ligjit "Për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë". Detyrat konkrete që mund të kryhen prej administratorit janë të autorizuara nga "Asambleja e ortakëvë". Të gjitha detyrat konkretisht janë të përcaktuara në Statutin e kësaj shoqërie tregtare.

Neni 11

Aktet dhe çdo dokument i shoqerise **Bujtina "KASO" SH.P.K.** hartohen nga Ortakët, nga "Asambleja e Ortakëve", nga Administratori apo nga organet zbatuese të saj, firmoset prej "Asamblesë së Ortakëve" ose vetëm nga Administratori i shoqërise sipas procedurave të përcaktuara në legjislacion. Emërtimi i shoqërisë do të shënohet në të gjitha dokumentat duke u ndjekur menjëherë nga inicialet Sh.P.K. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K.** do ketë vulën me logo të veçantë dhe me specimente të veçanta e cila do të përdoret në të gjitha dokumentat e hartuara gjatë gjithë veprimtarisë së saj.

Neni 12

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K** gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka të drejtë t'i përdorë ato në përputhje me objektin e qëllimin e veprimtarisë së saj dhe legjislacionin në fuqi. Pas miratimit të bilancit vjetor dhe raportit finansiar vjetor nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, fitimi neto i përket ortakut të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar Bujtina "KASO" SH.P.K në masën e kontributit të tij në kapitalin Themeltar dhe mund të përdoret lirisht prej tij brenda e jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 13

Shoqeria tregtare me përgjegjësi të kufizuar Bujtina "KASO" SH.P.K. mund të krijojë disa fonde. Ajo mund të krijojë: Fondin Themeltar, Fondin Rezervë e Fondin e Shpërbimit. Per zhvillimin e veprimtarisë së vet shoqeria mund të përcaktoje edhe fonde të tjera.

Neni 14

Shoqeria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K.** do të çelë llogari në Banka të ndryshme. Ajo do ta mbajë llogarinë dhe do ta deklarojë në Lekun Shqiptar por mund të mbajë llogaritë edhe në EURO, USD e në monedha të tjera të huaja. Në banka shoqëria mund të hapë llogari dhe të veprojë njëkohësisht me Lekun Shqiptar dhe me të gjitha monedhat e huaja në qarkullim. Veprimet bankare do të kryhen nga Administratori i Shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar Bujtina "KASO" SH.P.K. Z. Kasëm Ramadan Galla me Kombësi dhe Shtetësi Shqiptare e identifikuar me "Letërnjoftim/card Shqiptare Nr 036081168, Nr ID personal G90925155I, me



Akti i themelimit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar Bujtina "KASO" SH.P.K

datëlindje 25.09.1969 , i lindur dhe banues në Pogradec. Ai mund të veprojë me llogaritë bankare të shoqërisë personalisht ose edhe mund të autorizojë një person të tretë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 15

Veprimitaria ekonomike e financiare e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K** mbylltë më 31 Dhjetor të çdo viti. Bilanci vjetor i shoqërisë tregtare **Bujtina "KASO" SH.P.K.** duhet të miratohet nga "Asambleja e Ortakëve" brenda muajit Mars të vitit pasardhës, kurse vendimi për destinacionet e përdorimit të fitimit neto duhet të merret po nga "Asambleja e ortakëve" brenda dates 30 Qershori të vitit pasardhes.

Neni 16

Për nevoja të veprimitarisë së saj Shoqeria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K** mund të bëjë punësimë të punonjësve duke lidhur kontrata sipas legjislacionit në fuqi në secilin vend ku ushtron veprimitarinë e saj bazuar në rregullat konkrete të vendosura në statut.

Neni 17

Ortaku dhe personat që do të punesohen në shoqerinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K.** janë të detyruar të ruajnë karakterin e fshehtë të dokumentacionit, informacionit e burimit te tij, njojuritë e pervojën e fituar apo shkëmbyer në kuadrin e veprimitarisë së shoqërisë, si dhe fshehtësinë e gjëndjes financiare të saj. Ata janë të detyruar të ruajnë të fshehtë identitetin e shumave të depozitura, identitetin e burimeve të investimeve, destinacionet e të ardhurave të shoqërisë, e të depozitave të saj si dhe veprimitarinë e shoqërisë nga goditjet direkte dhe indirekte të konkurrencës. Ndaj atyre që shkelin këto rregulla, Asambleja e ortakëve dhe Administratori ka të drejtë të marrë masa ndëshkimore.

Neni 18

Kjo shoqëri tregtare merr cilësinë si "Person Juridik" me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë QKB-së. Ky Statuti i shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K** nënkupton se kjo shoqëri tregtare është deklaruar e krijuar me regjistrimin e saj në "Regjistrin Tregtar" dhe më pas të dhënat e saj janë të transferuara dhe të deklaruara në "Qëndren Kombëtare të Biznesit QKB". Përfundimisht ajo konsiderohet e krijuar nga dita kur ajo ka fituar statusin e Personit Juridik.

Neni 19

Të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve, si dhe ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë **Bujtina "KASO" SH.P.K** në lidhje me raportet shoqerore ose për intrepretimin dhe zbatimin e këtij statuti dhe të vendimeve ligjërisht të nxjerra nga "organet e shoqërise", nga ato të emëruara prej "Asamblesë së ortakëve" dhe nga administratorët, likuidatorët dhe titullarët ose në raportet me ta, për sa janë shtruar për kompromis, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe kur ato nuk gjejnë zgjidhjen e pranuar, sejçila palë mund ti drejtohet Gjykatës në Rrëthinë të cilin shoqëria ka Selinë. Kur mirëkuptimi me kompromise nuk arrihet pavarësisht nga negociatat e realizuara midis palëve, atëherë të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis "Shoqërisë tregtare" dhe palëve të tjera do të zgjidhen nëpërmjet Gjykatës së Rrëtit gjyqësor ku Shoqëria tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar **Bujtina "KASO" SH.P.K** ka selinë saj ose në gjykatën teritoriale ku ka ndodhur ngjarja.

ORTAKU THEMELUES
Kasëm Ramadan GALLA


4